



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 664/1 prot.

Tiranë më 4.04.2021

Lënda: Mendim për “Marrëveshjen mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe antiterrorizmit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe”.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), ka administruar shkresën tuaj me nr. 9316/5 Prot., datë 08.04.2021, nëpërmjet së cilës kërkohet mendim lidhur me “Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin në fushën e Sigurisë dhe Antiterrorizmit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe”.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk ka referenca në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në nenin 9 të projekt/marrëveshjes janë përcaktuar vetëm disa rregulla në lidhje me përdorimin e informacioneve dhe dokumenteve që shkëmbehen ndërmjet palëve.

Në referencë të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim Ligji) dhe Vendimit nr. 8 datë 31.10.2016 të Komisionerit, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Emiratet e Bashkuara Arabe konsiderohen shtet me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi nuk bën pjesë në listë.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se procesi i shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve ndërmjet palëve, nëse përmbajnë të dhëna personale, legjitimohet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 ligjit.

Me plotësimin e njërit prej këtyre kriterëve, Marrëveshja vlerësohet e hartuar konform Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

